



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 mars 2022
Nr. ref.:RK 1970/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastet nr. KI203/21 dhe nr. KI205/21

Parashtruesit

Nexhmije dhe Sahit Kabashi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Akgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Rev. nr. 80/2021, të 15 qershorit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KI203/21 është parashtruar nga Nexhmije Kabashi, dhe kërkesa KI205/21 është parashtruar nga Sahit Kabashi, që të dy me vendbanim në Komunën e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), Rev. nr. 80/2021, të 15 qershorit 2021 (në tekstin e mëtejme: vendimi i kontestuar), në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), AC. nr. 1360/18, të 16 tetorit 2020 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), C. nr. 225/2016, të 9 janarit 2018.
3. Aktgjykimi i kontestuar parashtruesve të kërkesës iu është dorëzuar më 15 korrik 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesve të kërkesës iu janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe nenet 10 dhe 17 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 9 nëntor 2021, parashtruesja e kërkesës në rastin KI203/21, nëpërmjet postës, e dorëzoi kërkesën e saj në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 16 nëntor 2021, Gjykata pranoi kërkesën e parashtruesit në rastin KI205/21.
8. Më 16 nëntor 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës në rastin KI203/21 për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 17 nëntor 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës në rastin KI205/21 për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
10. Më 22 nëntor 2021, në kërkesën me numër KI203/21, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Nexhmi Rexhepi.
11. Më 15 dhjetor 2021, në pajtim me paragrafin 1 të rregullit 40 (Bashkimi dhe ndarja e kërkesave) të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesës KI205/21 me kërkesën KI203/21.
12. Më 30 dhjetor 2021, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesave për regjistrimin e kërkesave dhe bashkimin e tyre, ndërsa parashtruesit të kërkesës në rastin KI205/21 i kërkoi që të dorëzojnë në Gjykatë formularin zyrtar të kërkesës, të plotësuar dhe nënshkruar.
13. Në të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi edhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesave dhe bashkimin e tyre. Po të njëjtën ditë, Gjykata i kërkoi Gjykatës Themelore fletëkthesën, e cila dëshmon se kur parashtruesit e kërkesës e kanë pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.
14. Më 18 janar 2022, Gjykata pranoi nga parashtruesi i kërkesës në rastin KI205/21 formularin e plotësuar dhe të nënshkruar të kërkesës.
15. Më 24 janar 2022, Gjykata i dorëzoi Gjykatës Themelore përsëritjen e kërkesës për dorëzimin e fletëkthesës. Po të njëjtën ditë, Gjykata i dorëzoi një kërkesë parashtruesve të kërkesës për dorëzimin e kopjeve: (i) të kërkesëpadisë, të parashtruar në Gjykatën Themelore; (ii) ankesës së parashtruar në Gjykatën e Apelit; dhe (iii) revizionit të tyre të parashtruar në Gjykatën Supreme.
16. Më 25 janar 2022, Gjykata pranoi nga Gjykata Themelore fletëkthesën që dëshmon se parashtruesit e kërkesës Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e kanë pranuar më 15 korrik 2021.
17. Më 4 shkurt 2022, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kopjet e: (i) kërkesëpadisë, të parashtruar në Gjykatën Themelore; (ii) ankesës së tyre të parashtruar në Gjykatën e Apelit; dhe (iii) revizionit në emër të parashtrueses së kërkesës KI203/21 [Nexhmije Kabashi], të parashtruar në Gjykatën Supreme.
18. Më 9 mars 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

19. Bazuar në dokumentet e dorëzuara me kërkesë, rezulton se parashtruesi i kërkesës në rastin KI205/21 është në lidhje bashkëshortore me parashtruesen e kërkesës në rastin KI203/21, dhe i njëjti është njëri nga pesë (5) fëmijët e e

I.K. dhe Xh.K., të cilët ndërruan jetë më 25 tetor 2012 dhe më 28 shkurt 2016, respektivisht. I.K. dhe Xh.K. kishin pesë (5) fëmijë, respektivisht, të bijtë Sh.K., i cili ndërroi jetë në Norvegji më 14 shtator 2012, Sahit Kabashin [parashtruesin e kërkesës në rastin KI205/21], I.I.K., me vendbanim në Kanada, dhe të bijat V.N. dhe S.B.

20. Objekt i çështjes së kontestit para gjykatave të rregullta është pronësia mbi paluajtshmërinë me shtëpi, e regjistruar në regjistrin kadastral [ngastra me nr. 5508/5] në Komunën e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: paluajtshmëria e kontestuar).
21. Në vitin 1977, I.K., të atit të parashtruesit të kërkesës në rastin KI205/21 iu nda trualli ndërtimor [në paluajtshmërinë e kontestuar], dhe me qëllim të ndërtimit të shtëpisë në këtë truall I.K. [i ati i parashtruesit të kërkesës në rastin KI205/21], parashtruesit e kërkesës dhe Sh.K. (i vëllai i parashtruesit të kërkesës), më 17 qershor 1978 lidhën kontratën mbi ndërtimin e përbashkët [Vr.nr. 496/78] të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjakovë.
22. Sipas deklaratave të parashtruesve të kërkesës dhe të paditurve, të ofruara në procedurë para Gjykatës Themelore gjatë periudhës së viteve 1978 dhe 1989, I.K., parashtruesit e kërkesës dhe Sh.K. me banka të ndryshme në atë kohë kishin lidhur kredi për ndërtimin dhe rregullimin e shtëpisë në paluajtshmërinë e kontestuar.
23. Në vitin 1980, parashtruesit e kërkesës ishin ndarë nga bashkësia familjare dhe vazhduan të jetojnë në shtëpinë e vjetër [e regjistruar si ngastër kadastrale me nr. 1047 në regjistrin kadastral të komunës së Gjakovës] në emër të I.K. Ndërsa I.K. me bashkëshorten e tij Xh.K. dhe me 4 (katër) fëmijët e tjerë të tyre, përkatësisht me djemtë e tyre Sh.K. dhe I.K., dhe të bijat V.N. dhe S.B. filluan të jetojnë në shtëpinë e re të ndërtuar në paluajtshmërinë e kontestuar.
24. Më 10 prill 1985, I.K., në bazë të Kontratës për dhurimin [Vr. nr. 426/85], i barti në pronësi të birit të tij, parashtruesit të kërkesës në rastin KI205/21 paluajtshmërinë me shtëpinë [në ngastrën kadastrale nr. 1047 në Gjakovë], ku ata ishin duke jetuar.
25. Më 29 dhjetor 1993, I.K. dhe Xh.K. me të birin e tyre Sh.K. [vëllain e parashtruesit të kërkesës në rastin KI205/21] lidhën Kontratën mbi mbajtjen e kujdesit të përjetshëm [V.nr.22/94], të legalizuar në Gjykatën Komunale në Gjakovë më 12 janar 1994. Sipas shkresave të lëndës, përmes kësaj kontrate ishte përcaktuar se Sh.K. obligohet që prindërit e tij I.K. dhe Xh.K. t'i mbajë dhe të kujdeset për tërë jetën, duke *"i siguruar me ushqim, veshmbathje, t'ju ofrojë ndihmë në rast të sëmundjeve eventuale, të jetojë në bashkësi familjare të tij"* dhe si kundërvlerë, I.K. si pranues i mbajtjes së përjetshme *"ja lënë në pronësi ofruesit të mbajtjes dhe kujdesit të përjetshëm [Sh.K.] paluajtshmërinë të lartshënuar, si dhe gjërat e luajtshme gjëre në momentin e fundit"*.
26. Më 15 prill 2009, respektivisht më 16 prill 2009 I.K. me të birin e tij Sh.K. lidhën Kontratën [Vr. nr. 1667/09] dhe aneks kontratën për dhurimin, përmes të cilës I.K. të birit të tij Sh.K. i dhuroi paluajtshmërinë e kontestuar.

27. Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton që më 28 shtator 2010 përmes Deklaratës [Vr. nr. 5583/10] së lidhur në mes Sh.K. dhe vëllait të tij I.I.K. [vëllait tjetër të parashtruesit të kërkesës në rastin KI205/21] ishte deklaruar që Sh.K. përmes kompensimit monetar në vlerë prej 15,000 (pesëmbëdhjetëmijë) eurove i kishte kompensuar I.I.K-së pjesën e tij në këtë paluajtshmëri.
28. Më 9 korrik 2012, Sh.K. dhe bashkëshortja e tij A.K. lidhën Kontratën [Vr. nr. 2669/12] për dhurimin e paluajtshmërisë së kontestuar, e cila më pas në regjistrin kadastral u regjistrua në emër të kësaj të fundit A.K..
29. Më 14 shtator 2012 Sh.K. [i vëllai i parashtruesit të kërkesës në rastin KI205/21] ndërroi jetë.
30. Më 25 tetor 2012, I.K. [i ati i parashtruesit të kërkesës në rastin KI205/21] ndërroi jetë.
31. Më 18 shkurt 2013, parashtruesit e kërkesës dhe Xh.K. [bashkëshortja e të ndjerit I.K., gjegjësisht e ëma e parashtruesit të kërkesës në rastin KI205/21] parashtruan kërkesëpadi në Gjykatën Themelore kundër A.K. [bashkëshortja e të ndjerit Sh.K.] përmes të cilës kërkuan: (i) Anulimin e Kontratës për mbajtjen e përrjetshme [V. nr. 22/94] të 29 dhjetorit 1993; (ii) Anulimin e Kontratës për dhurimin e paluajtshmërisë [Vr. nr. 1628/09] të 15 prillit 2009 (e korrigjuar me aneksin e kontratës [Vr. nr. 1667/09] të 16 prillit 2009; (iii) Anulimin e Kontratës për dhurimin e paluajtshmërisë [Vr. nr. 2669/12] të 9 korrikut 2012, e lidhur në mes të ndjerit Sh.K. dhe bashkëshortes së tij A.K.; dhe (iv) Vërtetimin e bashkëpronësisë të parashtruesve të kërkesës në 1/2 pjesë ideale në paluajtshmërinë e kontestuar, e regjistruar në emër të të paditurës A.K.. Më specifikisht, në kërkesëpadi, parashtruesit e kërkesës kërkuan që të shpallen bashkëpronarë të paluajtshmërisë së kontestuar, e cila paluajtshmëri në regjistrin kadastral të Gjakovës ishte e regjistruar si paluajtshmëri me kulturë shtëpi, në sipërfaqe prej 127 m², me kulturë oborr, në sipërfaqe prej 462 m², përkatësisht në sipërfaqen prej gjithsej 589 m². Në fund, parashtruesit e kërkesës po ashtu propozuan miratimin e masës së sigurimit ndaj paluajtshmërisë së kontestuar.
32. Në kërkesëpadinë e tyre, përkitazi me kontratën e dhurimit, të 15 prillit 2009, parashtruesit e kërkesës kishin specifikuar se atyre iu ishte cenuar pjesa e domosdoshme trashëgimore. Në lidhje me kontratat e dhurimit, parashtruesit e kërkesës po ashtu specifikuan se objekt i këtyre kontratave ishte paluajtshmëria me "kulturë jopjellore" e jo shtëpia. Sipas tyre, kjo paluajtshmëri më vonë nga e paditura A.K. ishte evidentuar në regjistrin kadastral si paluajtshmëri me kulturë shtëpi.
33. Parashtruesit e kërkesës në kërkesëpadinë e tyre theksuan se në lidhje me paluajtshmërinë e kontestuar kanë ofruar kontributin e tyre financiar për ndërtimin e shtëpisë përmes marrjes së kredive të ndryshme në bankat e atëhershme në Kosovë, dhe për të mbështetur këtë kërkuar edhe ekspertizë financiare dhe të ndërtimtarisë.

34. Në fund, përkitazi me kërkesën për vërtetimin e bashkëpronësisë së tyre në 1/2 pjesën ideale të paluajtshmërisë së kontestuar, parashtruesit e kërkesës theksuan se kjo kërkesë bazohet : *“në fitimin [e] të drejtës së pronësisë në bazë të kontributit në fitimin e truallit dhe kontributin në ndërtim dhe fitimi i të drejtës së pronësisë në paluajtshmëri sipas bazës së trashëgimisë, në atë pjesë modeste që mund ta kishte i ndjeri [I.K.]”*.
35. Në një datë të paspecifikuar, Xh.K.[nëna e parashtruesit të kërkesës në rastin KI205/21] në Gjykatën Themelore deponoi deklaratën, përmes të cilës deklaroi që heq dorë nga padia [C. nr. 105/13] e dorëzuar nga parashtruesit e kërkesës, pasi që sipas saj të njëjtën e ka nënshkruar nën presion dhe se dokumenti nuk i është prezantuar e as lexuar më parë.
36. Më 7 mars 2013, parashtruesit e kërkesës zgjeruan kërkesëpadinë e tyre, konkretisht si rezultat i deklaratës për tërheqje të padisë nga Xh. K., ata propozuan që kjo e fundit në kërkesëpadi të përfshihet si palë e paditur, dhe po ashtu propozuan që si të paditura të përfshihen edhe V.N.dhe S.B. [të bijat e të ndjerit I.K.].
37. Më 9 janar 2018, Gjykata Themelore në procedurë të shqyrtimit të meritave të kërkesëpadisë, përmes Aktgjykimit [C. nr. 225/2016] refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës: (i) për anulimin e kontratës, të 29 dhjetorit 1993 për mbajtjen e përjetshme e lidhur në mes të I.K. dhe Xh.K. dhe birit të tyre Sh.K; (ii) për anulimin e kontratës dhe aneks-kontratës, të 15 prillit 2009, respektivisht të 16 prillit 2009 e lidhur ndërmjet të ndjerit I.K. dhe birit të tij, tashmë të ndjerit Sh.K. për dhurimin e paluajtshmërisë së kontestuar; (iii) për anulimin e kontratës, së 9 korrikut 2012 e lidhur ndërmjet të ndjerit Sh.K. dhe bashkëshortes së tij A.K. për dhurimin e paluajtshmërisë së kontestuar; dhe (iv) për vërtetimin e pronësisë të parashtruesve të kërkesës në 1/2 pjesën ideale të paluajtshmërisë së kontestuar, e regjistruar në emër të të paditurës A.K.
38. Bazuar në këtë Aktgjykim, rezulton që Gjykata Themelore gjatë shqyrtimit të kërkesëpadisë së parashtruesve të kërkesës ka marrë për bazë deklaratat e palëve ndërgjyqëse në procedurë, kontratat e lartcekura, anulimi i të cilave është kërkuar, ka zhvilluar daljen në vend të ngjarjes, ka administruar dokumentacionin dhe provat e dorëzuara kësaj Gjykate, përfshirë edhe ato të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Gjakovës.
39. Së pari, Gjykata Themelore bazuar në provat dhe shkresat e lëndës vërtetoi se i ndjeri I.K. ishte pronar i paluajtshmërisë së kontestuar, me të cilën paluajtshmëri ka disponuar lirshëm dhe të cilën ia dhuroi djalit të tij Sh.K. fillimisht përmes Kontratës për mbajtjen e përjetshme, të 29 dhjetorit 1993 dhe më pas përmes Kontratës për dhurimin, të 15 prillit 2009, të cilat kontrata sipas kësaj gjykate, janë lidhur në pajtim me dispozitat ligjore dhe nuk janë në kundërshtim me ndonjë parim nga e drejta e detyrimeve. Sa i përket anulimit të Kontratës për mbajtjen e përjetshme, Gjykata Themelore konstatoi se e njëjta, në pajtim me dispozitat në fuqi, mund të anulohet vetëm nëse kërkohet nga palët kontraktuese dhe jo nga palët e treta.

40. Së dyti, sa i përket pretendimit të parashtruesve të kërkesës se përmes kontratave të dhurimit është cenuar pjesa e domosdoshme e trashëgimisë, Gjykata Themelore konstatoi se në këtë rast nuk është cenuar pjesa e domosdoshme e trashëgimisë së parashtruesve të kërkesës. Këtë konstatim, Gjykata Themelore e arsyetoi duke nënvizuar se në bazë të kontratës së dhurimit, të 10 prillit 1985, i ndjeri I.K., parashtruesit të kërkesës [Sahit Kabashit] i kishte dhuruar pronën me shtëpinë e vjetër në Gjakovë, e cila pronë më pas në regjistrin kadastral ishte regjistruar në emër të tij.
41. Së treti, përkitazi me kontratat e kredisë financiare të lidhura me banka të ndryshme, për të cilat parashtruesit e kërkesës në kërkesëpadinë e tyre kishin specifikuar se janë lidhur me qëllim të kontributit të tyre në ndërtimin e shtëpisë, Gjykata Themelore theksoi se: *“Gjykata në bazë të kontratave mbi kreditëka vërtetuar faktin se i ndjeri [I.K.], [Sh.K.] dhe [parashtruesit e kërkesës] kanë marrë kredi të ndryshme në vlera të ndryshme për ndërtimin e shtëpisë së re edhe pse ato kanë mundur të jenë kontrata fiktive pasi që palët në procedurë destinimin e këtyre shumave të kredisë nuk e kanë argumentuar me prova si fatura për blerjen e materialit ndërtimor për ndërtimin e shtëpisë [...]”*.
42. Në fund, Gjykata Themelore konstatoi se e paditura A.K., *“paluajtshmërinë lëndore e ka fituar në bazë të kontratës mbi dhurimin ku fitimi i pronësisë është paraparë si mund të fitohet me kontratë formale të paraparë sipas dispozitave ligjore e cila punë juridike është e vlefshme dhe në bazë të cilës fitohet e drejta e pronësisë, ku e [A.K.] ka bërë regjistrimin e paluajtshmërisë. Pra, mënyra derivative e fitimit të pronësisë ekziston, pronari të drejtën e vet pronësore e fiton nga pronari i mëparshëm i sendit, respektivisht te kjo mënyrë ka kontinuitet në mes të pronarit të mëparshëm me pronarin e ri të sendit”*.
43. Më 5 shkurt 2018, parashtruesit e kërkesës kundër Aktgjykimit [C. nr. 225/2016] të 9 janarit 2018, të Gjykatës Themelore parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
44. Në ankesën e tyre, parashtruesit e kërkesës në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, theksuan se *“dispozitivi është kontradiktor me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit, dhe se aktgjykimi nuk ka arsye për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta dhe kontradiktore dhe se për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit dhe të procesverbaleve për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre provave - dokumenteve dhe të procesverbaleve”*. Më tutje, parashtruesit e kërkesës në ankesën e tyre theksuan se objekt i faljes në kontratën për dhurimin e paluajtshmërisë së kontestuar në mes të I.K. dhe Sh.K., të 15 prillit 2009 dhe më pas në kontratën e dhurimit në mes të Sh.K. dhe A.K., të 9 korrikut 2012 ka qenë paluajtshmëria me kulturë jopjellore, dhe jo me kulturë shtëpi.

45. Po ashtu, në ankesën e tyre parashtruesit e kërkesës pohuan se: *“Në kohën e duhur, në shqyrtimin përgatitor kam propozuar që të caktohet edhe dhe ekspertizë financiare. Gjykata e shkallës së parë lidhur me ekspertizën e ndërtimtarisë nuk ka vendosur fare, ndërsa pa arsye është refuzuar propozimi për caktimin e ekspertit financiar”*.
46. Sipas parashtruesve të kërkesës tentativa për të dhuruar paluajtshmërinë e kontestuar përmes kontratës për mbajtjen e përjetshme në mes të I.K dhe Sh.K., të 29 dhjetorit 1993 është bërë me qëllim që: *“[...] të mos e ndanë por t'ia bartë njërit trashëgimtarë për të përjashtuar trashëgimtarë të tjerë. Ky qëndrim i Gjykatës argumenton se Kontrata për mbajtje të përjetshme ishte fiktive dhe simulative dhe për pasojë nule”,* si dhe e njëjta nuk mund të lidhet në mes të personave në faqefisni që kanë detyrimin e ushqimisë, siç është paraparë me nenin 284 [Rregulla e ndarjes së detyrimit të më shumë personave për dhënien e mbajtjes financiare] dhe 285 [Shtrirja e mbajtjes] të Ligjit 2004/32 për Familjen të Kosovës.
47. Më 16 tetor 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 1360/18] refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesve të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 225/2016] e Gjykatës Themelore, të 9 janarit 2018.
48. Gjykata e Apelit fillimisht Aktgjykimin e Gjykatës Themelore e vlerësoi si të drejtë dhe të ligjshëm, dhe për pasojë konstatoi se i njëjti nuk ishte i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
49. Në vijim, përkritazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për vërtetim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit gjeti se *“gjykata e shkallës së parë në procedurën e administrimit të provave i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit të ankimuar. Gjykata e Apelit, në bazë të provave të administruara nga ana e Gjykatës Themelore gjeti se parashtruesit e kërkesës me asnjë provë konkrete dhe valide nuk kanë arritur të provojnë faktin se atyre iu takon e drejta e bashkëpronësisë në ngastrat kadastrale të cilat janë objekt i këtij kontesti dhe të cilat evidentohen në emër të [A.K.]”*.
50. Në lidhje me kontratën e dhurimit, të 9 korrikut 2012, ndërmjet të ndjerit Sh.K. dhe bashkëshortes së tij A.K., Gjykata e Apelit gjeti se: *“[...] është sqaruar drejtë përmes aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së parë, ku përmes kësaj kontrate këtu e paditura e parë [A.K.] është bërë pronare e paluajtshmërisë kontestuese në mënyrë të ligjshme dhe me mirëbesimin, kontratë e cila është në fuqi dhe pastaj kjo paluajtshmëri i ka kaluar në emër të [A.K.] në librat kadastral”. Në vijim, Gjykata e Apelit gjeti se: “Është vlerësimi i kësaj gjykate se [parashtruesit e kërkesës] nuk mund të kërkojnë anulimin e kontratës së dhurimit, e aq më tepër kontratën për mbajtje të përjetshme pasi që kjo kontratë ka qenë me detyrime të dyanshme, e të cilave detyrime e paditura përkatësisht paraardhësi i tij i është përmbajtur në tërësi, e të cilat janë lidhur në mënyrë ligjore nga ana e palëve nënshkruese, të cilat kontrata janë ndërlidhur me ndërgjeshmëri e mirëbesim, ngase marrëdhëniet kontraktuale janë kryer me pronarët juridikë të ngastrës*

kadastrale kontestuese dhe në të cilat kontrata [parashtruesit e kërkesës] nuk kanë qenë palë kontraktuese”.

51. Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, Gjykata e Apelit vlerësoi se Gjykata Themelore Aktgjykimin e saj e nxori në zbatim të drejtë të dispozitave ligjore, përkatësisht në pajtim me dispozitat e kapitullit III të Ligjit nr. 03/L-154 mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (në tekstin e mëtejme: Ligji për Pronësinë] dhe nenin 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore Juridike.
52. Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj po ashtu theksoi se: *“[...] ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat kanë qenë pa ndikim për ndonjë vendim tjetër nga sa u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi”.*
53. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga parashtruesit e kërkesës në Gjykatë, rezultoi që, më 17 nëntor 2020, parashtruesja e kërkesës në rastin KI203/21 [Nexhmije Kabashi] parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të lartçekur të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesja e kërkesës në rastin KI203/21, në revizionin e saj theksoi se: *“Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e Apelit e Kosovës është marrë vetëm me raportet e bashkëshortit tim me familjarët e tij, e jo edhe me kontributin tim direkt dhe bashkësisë familjare sa kemi jetuar me një bashkësi të përbashkët. Për të vërtetuar ato pretendime është kërkuar ekspertizë financiare dhe të ndërtimtarisë. Janë refuzuar ato propozime”.* Për më tepër, e njëjta, pretendoi se: *“[...] unë si e punësuar, gjatë kohës sa kemi qenë në një bashkësi familjare, sipas traditave të vendit rrogën time me shirit, si paguhej atëherë i kam dorëzuar vjehrrit tim tash të ndjerë [I.K.]. Gjatë asaj bashkësie familjare dhe ekonomike unë kam marrë kredira, të cilat i kam kthyer edhe pasi që është shkëputur bashkësia familjare dhe ekonomike me vjehrrin tim dhe kunatin”.*
54. Më 15 qershor 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr. 80/2021] refuzoi si të pathemeltë revizionin e parashtruesve të kërkesës.
55. Bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, rezultoi se parashtrues të revizionit në Gjykatën Supreme janë dy parashtruesit e kërkesës. Megjithatë, në dokumentacionin e dorëzuar në Gjykatë mungon kopja e revizionit të dorëzuar edhe në emër të parashtruesit të kërkesës në rastin KI205/21 [Sahit Kabashi].
56. Gjykata Supreme, fillimisht iu referua historiatit të lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër [nr. 952-03-237/16] të 10 nëntorit 2016, përmes të cilit është saktësuar se (i) në vitin 1978, parcela nr. 5508/5 [paluajtshmëria e kontestuar] është evidentuar në posedim të [I.K.]; (ii) në vitin 2009, në bazë të kontratës mbi dhurimin [Vr. nr. 1667/09] të 16 prillit 2009 parcela në emër të [I.K.] ka kaluar në posedim të [Sh.K.] (regjistri i ndërrimeve 75/09); (iii) në vitin 2012 në bazë të kontratës mbi dhurimin [Vr. nr. 2669/12] të 9 korrikut 2012 kjo parcelë nga [Sh.K.] kalon në posedim të [A.K.] (regjistri i ndërrimeve

242); (iv) në vitin 2012 ishte realizuar incizimi i objektit të ri në parcelën [nr. 5508/5] në bazë të kërkesës nr. 1222/12 të 5 nëntorit 2012, aktvendimet të lejes së ndërtimit, të 6 korrikut 1977; dhe (v) si rrjedhojë, parcela nr. 5508/5 figuron me kulturë shtëpi në sipërfaqe prej 0.01.27 ha dhe oborr në sipërfaqe prej 0.04.62 ha.

57. Gjykata Supreme, në thelb, e konsideroi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatave të shkallës më të ulët dhe vlerësoi se nuk qëndrojnë pretendimet e revizionit lidhur me (i) nulitetin e kontratave të dhurimit; (ii) cenimit të pjesës së domosdoshme të trashëgimisë; dhe (iii) vërtetimit të pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese. Në lidhje më këtë të fundit, Gjykata Supreme specifikoi se: *“[...] sepse në bazë të dispozitave ligjore, (neni 20 i LMTHPJ-së [Ligji mbi marrëdhëniet themelore juridike-pronësore], përkatësisht, neni 36 i LPDS-së [Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore]) rezulton se e drejta e pronësisë fitohet sipas ligjit, në bazë të veprimit juridik (punës juridike) dhe me trashëgimi apo me vendim të organit shtetëror në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me ligj. Në rastin konkret juridiko-civil [parashtruesit e kërkesës] nuk e kanë provuar as bazën juridike e as mënyrën e fitimit (iustus titullus-modus aquirendi) të pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese. Ndërkohë që, kontratat e sipërpërmendura (si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë), anulimin e të cilave e kërkojnë [parashtruesit e kërkesës] me padi, nuk janë lidhur në kundërshtim me dispozitat e nenit 103 dhe nenit 111 të LMD-së [Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve], nuk janë në kundërshtim, pra, me parimet dhe rendin juridik kushtetues, me dispozitat imperative etj, të njëjtat nuk janë lidhur me (vi, clam, precario) me mashtrim, kërcenim, lajthim. Në anën tjetër, rezulton, po ashtu, se e drejta e pronësisë, është bartur në të paditurën e parë [A.K.], në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi [...]”*.
58. Në vijim, përkitazi me kërkesën e parashtruesve për anulimin e kontratës për mbajtjen e përjetshme dhe pretendimit se ishte cenuar pjesa e domosdoshme e trashëgimisë, Gjykata Supreme vlerësoi se: *“[...] në rastin konkret juridiko-civil, nuk kemi të bëjmë me cenimin e pjesës së domosdoshme (portio legitima), për faktin sepse sipas nocionit ligjor të Kontratës mbi mbajtjen e përjetshme rezulton se e njëjta nuk është kontratë për trashëgiminë. Ajo është një kontratë me prestime dhe detyrime të dyanshme, me të cilën ushqimmarrësi disponon gjatë jetës me pasurinë e tij. Me këtë kontratë tjetërsohet pasuria e cila është objekt i saj, prandaj, pasuria e cila është objekt i kontratës nuk bën pjesë në masën trashëgimore të ushqimmarrësit dhe e cila nuk mund të shqyrtohet me rastin e shqyrtimit të trashëgimisë së tij, pasi që gjatë jetës së tij është tjetërsuar nga ai. Nga këtu, trashëgimtarët e domosdoshëm nuk mund ta atakojnë kontratën mbi mbajtjen e përjetshme për shkak të cenimit të pjesës së domosdoshme, nga se, u mor vesh, fjala është për kontratë ngarkuese në të cilën reduktimi në dobi të trashëgimtarëve të domosdoshëm nuk vjen në shprehje, ndërkohë që, gjithnjë në kontekstin e mësipërm dhe në llogari të këtij konkludimi, duhet theksuar edhe njëherë faktin se [parashtruesi i kërkesës në rastin KI205/21] nga i ndjeri [I.K.] qysh në vitin 1985 kishte marrë dhuratë paluajtshmërinë e sipërpërmendur [...]”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

59. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, në lidhje me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore kanë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; 46 [Mbrojtja e Pronës]; 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe nenet 10 dhe 17 të DUDNJ-së.
60. Parashtruesit e kërkesës në thelb pretendojnë se janë bashkëpronarë në 1/2 pjesë ideale të paluajtshmërisë së kontestuar, dhe se këtë bashkëpronësi e kanë fituar me kontribut përmes dhurimit të pagave dhe kredive që i kanë marrë në periudhën "1978-1990" për ndërtimin e shtëpisë në përputhje me zotimet sipas "Kontratës mbi ndërtimin e përbashkët" të lidhur më 10 maj 1978, në mes të I.K., Sh.K., dhe parashtruesve të kërkesës.
61. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme në lidhje me aktgjykimet e gjykatave të shkallës më të ulët "[...] për pretendimet e tyre specifike përkitazi me lëndën e tyre nuk kanë dhënë asnjë arsye, kështu që aktgjykimi i atakuar është arbitrare dhe i njëanshëm, pa arsye për pretendimet e mia, që paraqet bazë të njëjtë të deklarohet kundër kushtetues". Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesit e kërkesës i referohen rastit të Gjykatës KI97/19 [me parashtrues *Gëzim Sadrija, Gazmend Sadrija dhe Hidajte Sadrijaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 tetorit 2019], ku Gjykata vëren se i njëjti i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) sa i përket vendimit të paarsyetuar gjyqësor, përkatësisht rasteve të GJEDNJ-së: *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykim i 22 shkurtit 2007; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998; *Papon kundër Francës*, Aktgjykim i 7 qershorit 2001; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999; *Helle kundër Finlandës*, Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 majit 2005; dhe *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006, si dhe rasteve të Gjykatës: KI97/16, me parashtrues *"IKK Classic"*, Aktgjykim i 9 janarit 2018, para. 46; KI22/16, me parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017, para. 40, dhe K172/12, me parashtrues *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61).
62. Gjithashtu, parashtruesit e kërkesës pohojnë se në seancën përgatitore kishin propozuar ekspertizë të ndërtimtarisë dhe caktimin e një eksperti financiar dhe sipas tyre në lidhje me ekspertizën e ndërtimtarisë, Gjykata Themelore nuk kishte vendosur fare, ndërsa kërkesën për caktimin e ekspertit financiar e kishte refuzuar. Në kontekst të këtij pretendimi, parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të neneve 31, 53 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

63. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pohojnë se refuzimi i propozimit për prova paraqet shkelje të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, përkatësisht, shkelje të neneve 31, 53 dhe 54 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së. Kjo për shkak se gjatë procedurës së shkallës së parë në shqyrtimin përgatitor kanë propozuar që të caktohet ekspertizë e ndërtimtarisë dhe ekspertizë financiare, ndërsa kjo gjykatë lidhur me kërkesën e parë nuk ka vendosur fare, kurse kërkesën e dytë e ka refuzuar pa arsye.
64. Parashtruesit e kërkesës po ashtu pretendojnë se: *“Lidhur me pikën 11. të ankesës, lidhur me parashtrimet ankimore e as e revizionit nuk ka dhënë asnjë arsye, asnjë koment, e atë lidhur me konstatimet dhe rrethanat kontestuese:*
- a. I ndjeri Islam ka pasur bashkëshorten [Xh.K.], të birin Sahitin [këtu paditësi, parashtruesi i kërkesës], të birin tash të ndjerin [Sh.K.], i cili ka jetuar e më pastaj ka vdekur në Norvegji, me dt. 14. shtator 2012, ku edhe është varrosur, dhe të birin [I.I.K.] që jeton jashtë vendit dhe bijat [V.N.], e lindur Kabashi dhe [S.B.], e lindur Kabashi.*
- b. Tash i ndjeri [Sh.K.], vëllai i paditësit Sahit [parashtruesit të kërkesës], i cili siç u cek ka vdekur 1 muaj e 11 ditë para vdekjes së babait [I.K.], pas vdekjes ka lënë bashkëshorten, këtu të paditurën [A.K.] dhe fëmijët e tyre, dmth. të ndjerit [Sh.K.] dhe të paditurat [A.K.] dhe atë [V.K.], [S.K.], dhe [Z.K.], të cilët jetojnë në Oslo, Norvegji.*
- c. Se i biri i vogël i të ndjerit [I.K.], përkatësisht vëllai i vogël i paditësit Sahit [parashtruesit të kërkesës], [I.I.K.] në Toronto, Kanada, edhe pse duhej të ishte palë në procedurë, si bashkëndërgjyqës i domosdoshëm.*
- d. Që paditësit me fëmijët e tyre jetojnë në një shtëpi të ujetër prej 70 m² dhe oborr prej 170 m², e cila evidencohet si ngastër kadastrale 1047, ZK Gjakovë-qytet, e cila i është bartur paditësit të parë me Kontratën për dhurimin e lidhur e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjakovë nën Vr.nr. 426/85 të dt. 10.04.1985, në të cilën ka mbetur të jetoj paditësi me familjen e tij pasi që babai i ndjerë me familjarët tjerë kaluan të jetojnë në shtëpine e re, përkatësisht paluajtshmërinë e cila është objekt i këtij kontesti”.*
65. Më tej, parashtruesit e kërkesës theksojnë se: *“Lidhur me paluajtshmërisë Vr.nr. 1667/09 të datës 16.04.2009 [kontrata e dhurimit] objekt i faljes ishte paluajtshmëria me kulturë JOPJELLORE, ashtu që objekt kontratës nuk ishte shtëpia por vetëm toka e zbrazët ndërtimore. Këtë pretendim ankimor Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar siç që nuk e ka shqyrtuar të njëjtin pretendim as Gjykata Supreme e Kosovës në aktgjykimin e atakuar”.*
66. Parashtruesja e kërkesës në rastin KI203/21 po ashtu thekson se *“mangësia e arsyesimit për çështje fundamentale është në kufirin e arbitraritetit dhe shkel të drejtën në gjykim të drejtë dhe korrekt, posaçërisht të drejtën time si femër, duke me diskriminuar, që paraqet edhe shkelje të drejtës në barazi dhe në garancionet tjera kushtetuese”.*
67. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të: (i) deklarojë kërkesën e tyre të pranueshme, si dhe (ii) të konstatojë se Aktgjykimi i

kontestuar i Gjykatës Supreme nuk është në pajtueshmëri me nenet 31, 46 dhe 53 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, dhe nenet 10 dhe 17 të DUDNJ-së.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
- 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.*
- 4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.*
- 5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.*
- 6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.*
- 7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.*

Neni 46

[Mbrojtja e Pronës]

- 1. E drejta e pronës është e garantuar.*
[...]

Neni 53

[Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 54

[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 (E drejta për gjykim të drejtë)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm [...].

Prokollli nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 1 (Mbrojtja e pronës)

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Neni 10

Secili ka të drejtë plotësisht të barabartë për gjykim të drejtë dhe publik para një gjykate të paanshme e të pavarur që do të vendosë për të drejtat dhe detyrimet e tij dhe për mbështetshmërinë e çdo akuze penale kundër tij.

Neni 17

- 1. Secili ka të drejtë të ketë pasuri, vetë dhe në bashkësi me të tjerët.*
- 2. Askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij.*

LIGJI NR. 03/L-154 PËR PRONËSINË DHE TË DREJTAT TJERA SENDORE

KAPITULLI III FITIMI DHE HUMBJA E PRONËSISË NË PALUAJTSHMËRITË

Neni 36 Fitimi i pronësisë në paluajtshmëri

- 1. Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri.*
- 2. Kontrata për bartjen e paluajtshmërisë duhet të lidhet me shkrim në prezencë të dy palëve në një zyrë kompetente.*

LIGJI NR. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE

PJESA V KONTRATA PËR MBAJTJEN E PËRJETSHME

Neni 560 Përkufizimi

- 1. Me anë të kontratës për mbajtjen e përjetshme, një palë kontraktuese (dhënësi i mbajtjes) merr përsipër të ndihmojë palën tjetër kontraktuese apo ndonjë person tjetër (marrësin e mbajtjes) dhe pala tjetër kontraktuese deklaron se ai apo ajo do t'i dorëzojë të parit (dhënësit të mbajtjes) të gjithë pasurinë apo një pjesë të pasurisë së tij apo sajë, e përbërë nga pasuria e përgjithshme dhe pasuria e luajtshme e dedikuar për ta përdorur dhe gëzuar pasurinë e përgjithshme, me ç'rast dorëzimi i tillë shtyhet deri në kohën e vdekjes së dorëzuesit.*
- 2. Kjo kontratë gjithashtu mund të përfshijë edhe pasuri tjetër të luajtshme të marrësit të mbajtjes, e cila duhet të theksohet në kontratë.*
- 3. Kontratat me të cilat arrihet marrëveshja për premtimin e trashëgimit të një bashkimi të përjetshëm apo një bashkim i pasurisë ose një palë kontraktuese pajtohet që të kujdeset dhe të mbrojë palën tjetër, të punoj pronën e tij apo saj të kryej të gjitha ceremonitë e funeralit pas vdekjes së tij apo saj, apo çdo gjë tjetër për të njëjtin qëllim duhet të konsiderohen kontrata për mbajtjen e përjetshme.*

LIGJI Nr. 2004/32 PËR FAMILJEN I KOSOVËS

Neni 284 Rregulla e ndarjes së detyrimit të më shumë personave për dhënie e mbajtjes financiare

Në rast se më shumë se një person ka nevojë dhe personi që ka detyrim të sigurojë mbajtje financiare për të gjithë nuk është në gjendje të ofrojë mbajtje të plotë nën arsyet e cekura në nenin 280, detyrimi ndahet mes të gjithë të afërmeve që janë të detyruar derisa mbajtja financiare të jetë garantuar plotësisht.

Neni 285. Shtrirja e mbajtjes

(1) Shtrirja e mbajtjes duhet të jetë adekuate me kushtet nën të cilat ka jetuar personi që ka të drejtë në mbajtje. Në rast se personi ka jetuar në

kushte të rënda, mbajtja duhet të sigurojë së paku minimumin që nevojitet për të mbajtur një jetë të rëndomtë dinjitoze.

(2) Mbajtja përfshin të gjitha kërkesat e domosdoshme për jetë, duke përfshirë të gjitha shpenzimet e domosdoshme për trajnim dhe shkollim për të fituar profesion.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

68. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

69. Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë se:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

70. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht secilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]

71. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës janë: palë e autorizuar; kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 80/2021], të 15 qershorit 2021; kanë saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendojnë se i janë shkelur; kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, si dhe, e kanë dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.
72. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, paragrafi (2) i rregulli 39 të Rregullores së punës, përcakton që:
- "(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*
73. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *"qartazi e pabazuar"* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si *"pretendime qartazi të pabazuara"*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *"të shkallës së katërt"*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *"mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes"*; (iii) pretendime *"të pambështetura apo të paarsyetuara"*; dhe në fund, (iv) pretendime *"konfuze dhe të paqarta"*. Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si *"qartazi të pabazuar"*, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si *"qartazi të pabazuara"* të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore, përfshirë, por duke mos u kufizuar në rastet KI40/20 me parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2021; KI163/18, me parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; KI21/21, me parashtrues, *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 prillit 2021, KI107/21, me parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 tetorit 2021).
74. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

75. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës për vërtetimin e bashkëpronësisë së tyre në 1/2 pjesë ideale të paluajtshmërisë së kontestuar, e cila paluajtshmeri në vitin 1993 dhe në vitin 2012 përmes kontratës për mbajtje të përjetshme dhe kontratës së dhurimit, respektivisht nga i ndjeri I.K. [i ati i parashtruesit të kërkesës në rastin KI205/21] i ishte bartur të birit të tij, tashmë të ndjerë Sh.K. [vëllait të parashtruesit të kërkesës në rastin KI205/21]. Në vitin 2012 kjo paluajtshmeri si rezultat i kontratës së dhurimit të lidhur ndërmjet të ndjerit Sh.K. dhe bashkëshortes së tij A.K. në regjistrin kadastral të Komunës së Gjakovës ishte regjistruar në emër të A.K. Për pasojë, parashtruesit e kërkesës, në vitin 2013, në Gjykatën Themelore kishin parashtruar kërkesëpadi për (i) vërtetimin e pronësisë në 1/2 pjesën ideale të paluajtshmërisë së kontestuar; (ii) anulimin e kontratës për mbajtjen e përjetshme, të 29 dhjetorit 1993, të lidhur në mes të tash të ndjerëve, I.K. dhe të birit të tij Sh.K. përmes të cilës kontratë palujatshmeria e kontestuar kalonte në posedim të Sh.K.; (iii) anulimin e kontratës për dhurimin e paluajtshmërisë, të vitit 2009 në mes të I.K. dhe Sh.K. dhe po ashtu (iv) anulimin e kontratës, të vitit 2012 të lidhur në mes të Sh.K. dhe bashkëshortes së tij, A.K. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit të saj [C.nr.225/2016] të 9 janarit 2018 e kishte refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës, duke vërtetuar në thelb se pronësia e regjistruar në emër të A.K. ishte fituar në bazë të dispozitave ligjore në fuqi. Si rezultat i ankesës së parashtruesve të kërkesës në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit përmes Aktgjykimit të saj [AC. nr. 1360/18] të 16 tetorit 2020, refuzoi ankesën e tyre si të pathemeltë dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Në vijim, si rezultat i revizionit të parashtruar nga parashtruesit e kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme, kjo e fundit përmes Aktgjykimit të saj të kontestuar kishte refuzuar revizionin e tyre si të pathemeltë duke vërtetuar se nuk qëndrojnë pretendimet e revizionit lidhur me (i) nulitetin e kontratave të dhurimit; (ii) cenimit të pjesës së domosdoshme të trashëgimisë; dhe (iii) vërtetimit të pronësisë në paluajtshmerinë kontestuese.
76. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë konstatimet e Gjykatës Supreme, dhe në kërkesën e tyre në kuptim të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së pretendojnë mungesë të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe po ashtu pretendojnë se Gjykata Themelore nuk ka aprovuar kërkesën e tyre për caktimin e ekspertizës së ndërtimtarisë dhe ekspertit financiar. Në kontekst të këtyre pretendimeve, parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të neneve 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
77. Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata vë në pah se ky nen nuk i referohet ndonjë të drejte specifike, të garantuar me Kapitullin II të Kushtetutës, por përcakton detyrimin që: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*. Në lidhje me këtë detyrim, ashtu siç është cekur edhe më lart, Gjykata gjatë vlerësimit të

pretendimeve të parashtruesve të kërkesës do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

78. Megjithatë, në kuptim të pretendimit të parashtruesve të kërkesës në kërkesat e tyre se Gjykata Supreme nuk ka adresuar pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës në revizion, përfshirë edhe pretendimin e tyre për mosadresimin dhe arsyetimin e tyre përkitazi me refuzimin për ekspertizë financiare, Gjykata do t'i trajtojë në kuptim të garancive të ofruara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
79. Në kërkesën e tyre, parashtruesit e kërkesës po ashtu pretendojnë shkelje të së drejtës së tyre në pronë, të garantuar me nenet 46, në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenit 17 të DUDNJ-së.
80. Bazuar në atë si më lart, Gjykata në vijim do të shqyrtojë dhe vlerësojë kërkesën e parashtruesve të kërkesës përkitazi me:
 - I. Pretendimin e tyre për mungesë të arsytimit të vendimit gjyqësor, gjegjësisht mosadresimit të pretendimeve të tyre thelbësore të ngritura në revizion para Gjykatës Supreme në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; dhe
 - II. Pretendimet e tyre për shkelje të nenit 46, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenit 17 të DUDNJ-së; dhe

I. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

81. Në kuptim të këtij pretendimi, parashtruesit e kërkesës theksojnë se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk plotëson standardin e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, si rezultat i mosadresimit të pretendimeve të tyre thelbësore të parashtruara në revizionin e tyre në Gjykatën Supreme. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës, në mënyrë specifike i referohen pretendimeve të tyre se objekt i kontratës së dhurimit, të 16 prillit 2009 në mes të të ndjerëve I.K. [i ati i parashtruesit të kërkesës në rastin KI205/21] dhe Sh.K. [vëllai i parashtruesit të kërkesës në rastin KI205/21], ishte paluajtshmëria me kulturë jopjellore, por jo edhe shtëpia, dhe se në kërkesëpadinë e tyre kishin kërkuar caktimin e ekspertizës financiare për të mbështetur kontributin e tyre në ndërtimin e shtëpisë, e cila përbën objekt lëndor të kërkesëpadisë së tyre.
82. Si rezultat i kësaj, Gjykata gjatë adresimit të pretendimit të tyre për mosarsyetim të vendimit gjyqësor, përkatësisht mosadresimit të pretendimeve të tyre thelbësore në revizion do të trajtojë edhe pretendimin e tyre përkitazi me refuzimin për caktimin e ekspertizës financiare.
83. Rrjedhimisht, Gjykata fillimisht do t'i shtjellojë shkurtimisht parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për vendim të arsyetuar gjyqësor të vendosura përmes praktikës së GJEDNJ-së dhe të Gjykatës; dhe më pas, do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

84. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës KI230/19, me parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin KI87/18, me parashtrues *IF Skadiforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 44).
85. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore, gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, i cituar më lart, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, i cituar më lart, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, i cituar më lart, paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, me parashtrues *IKK Classic*, i cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18, me parashtrues *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin *Moreira Ferreira kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 5 korrikut 2011, paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastet e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137, KI107/21, me parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 tetorit 2021, paragrafët 69).
86. Gjykata fillimisht vë në pah se bazuar në Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, kjo e fundit kishte refuzuar kërkesën e revizionit të të dy parashtruesve të kërkesës, përkatësisht palë në procedurë para kësaj gjykate ishin dy parashtruesit e kërkesës.
87. Në kuptim të kësaj, Gjykata me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës të ngritura në kërkesën e tyre të dorëzuar më 21 nëntor 2021 në Gjykatë, rikujton se të njëjtëve më 24 janar 2022, ndër tjerash iu kishte kërkuar dorëzimin e kopjes së revizionit të tyre të parashtruar në Gjykatën Supreme. Më 4 shkurt 2022, në Gjykatë ishte dorëzuar vetëm kopja e revizionit e dorëzuar në Gjykatën Supreme në emër të parashtrueses së kërkesës në rastin KI203/21 [Nexhmije Kabashi].
88. Bazuar në revizionin e dorëzuar në emër të parashtrueses së kërkesës në rastin KI203/21 [Nexhmije Kabashit], rezulton që kjo e fundit përmes revizionit të saj kishte pretenduar se: "*Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e Apelit e Kosovës është marrë vetëm me raportet e bashkëshortit tim me familjarët e tij, e jo edhe me kontributin tim direkt dhe bashkësisë familjare sa kemi jetuar me një bashkësi të përbashkët. Për të vërtetuar ato pretendime është kërkuar*

ekspertizë financiare dhe të ndërtimtarisë. Janë refuzuar ato propozime". Në vijim, e njëjta, pretendoi se: *"[...] unë si e punësuar, gjatë kohës sa kemi qenë në një bashkësi familjare, sipas traditave të vendit rrogën time me shirit, si paguhej atëherë ia kam dorëzuar vjehrrit tim tash të ndjerë [I.K]. Gjatë asaj bashkësie familjare dhe ekonomike unë kam marr kredira, të cilat i kam kthyer edhe pasi që është shkëputur bashkësia familjare dhe ekonomike me vjehrrin tim dhe kunatin"*.

89. Në adresimin e pretendimeve të lartcekura të parashtruesve të kërkesës, Gjykata fillimisht vë në pah se kërkesëpadia e tyre ishte refuzuar nga Gjykata Themelore, konstatimi i të cilës ishte vërtetuar edhe përmes Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe në fund, si rezultat i revizionit të parashtruar në Gjykatën Supreme, kjo e fundit kishte refuzuar revizionin e dy parashtruesve të kërkesës, duke vërtetuar në tërësi konstatimet e gjykatave të shkallës më të ulët.
90. Prandaj, Gjykata fillimisht i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, nga përmbajtja e të cilit rezulton se kjo e fundit gjatë shqyrtimit të kërkesëpadiës së parashtruesve të kërkesës ka marrë për bazë deklaratat e palëve ndërgjyqëse në procedurë, kontratat e lartcekura, anulimi i të cilave është kërkuar, ka zhvilluar daljen në vend të ngjarjes, ka administruar dokumentacionin dhe provat e dorëzuara kësaj Gjykate, përfshirë edhe ato të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Gjakovës [Historiati i lëshuar nga kjo drejtori më 10 nëntor 2016].
91. Përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës se këta të fundit kanë lidhur kontrata të ndryshme të kredisë për ndërtimin e shtëpisë, objekt lëndor i kërkesëpadiës së tyre, i cili pretendim ndërlidhet edhe me çështjen e ekspertizës financiare, Gjykata Themelore kishte konstatuar si në vijim: *"Gjykata në bazë të kontratave mbi kreditë vërtetoi faktin se i ndjeri [I.K], Sh.K], [parashtruesit e kërkesës] kanë marrë kredi të ndryshme në vlera të ndryshme për ndërtimin e shtëpisë së re edhe pse ato kanë mundur të jenë kontrata fiktive pasi që palët në procedurë destinimin e këtyre shumave të kredisë nuk e kanë argumentuar me prova si fatura për blerjen e materialit ndërtimor për ndërtimin e shtëpisë [...]"*.
92. Për më tepër, Gjykata Themelore bazuar në provat dhe shkresat e lëndës vërtetoi se: (i) i ndjeri I.K. [i ati i parashtruesit të kërkesës në rastin KI205/21] ishte pronar i paluajtshmërisë së kontestuar, me të cilën paluajtshmëri ka disponuar lirshëm dhe të cilën ia dhuroi djalit të tij Sh.K. [vëllait të parashtruesit të kërkesës në rastin KI205/21] fillimisht përmes Kontratës për mbajtjen e përjetshme, të 29 dhjetorit 1993 dhe më pas përmes Kontratës për dhurimin, të 15 prillit 2009 kontrata të cilat sipas kësaj gjykate janë lidhur në pajtim me dispozitat ligjore dhe nuk janë në kundërshtim me ndonjë parim nga e drejta e detyrimeve; (ii) nuk është cenuar pjesa e domosdoshme e trashëgimisë, duke vlerësuar se në bazë të kontratës së dhurimit, të 10 prillit 1985, i ndjeri I.K. parashtruesit të kërkesës i kishte dhuruar pronën me shtëpinë e vjetër në Gjakovë, e cila pronë më pas ishte regjistruar në librin e paluajtshmërive në emër të tij; dhe se (iii) e paditura A.K. [bashkëshortja e të ndjerit Sh.K], të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë e kontestuar e ka fituar

në bazë të kontratës mbi dhurimin, duke vijuar me arsyetimin se “[...] mënyra derivative e fitimit të pronësisë ekziston, pronari të drejtën e vet pronësore e fiton nga pronari i mëparshëm i sendit, respektivisht te kjo mënyrë ka kontinuitet në mes të pronarit të mëparshëm me pronarin e ri të sendit”.

93. Në vijim, Gjykata po ashtu i referohet edhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit e cila kishte vërtetuar qëndrimin dhe konstatimin e Gjykatës Themelore. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata e Apelit në thelb kishte konstatuar se: (i) Gjykata Themelore në procedurën e administrimit të provave i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit të ankimuar, dhe si rrjedhojë bazuar në provat e administruara nga ana e Gjykatës Themelore gjeti se parashtruesit e kërkesës me asnjë provë konkrete dhe valide nuk kanë arritur të provojnë faktin se atyre iu takon e drejta e bashkëpronësisë në paluajtshmërinë e kontestuar të regjistruar në emër të A.K; (ii) kontratat për mbajtjen apo kujdesin e përjetshëm dhe ato të dhurimit janë *“lidhur në mënyrë ligjore nga ana e palëve nënshkruese, të cilat kontrata janë ndërlidhur me ndërgjeshmëri e mirëbesim, ngase marrëdhëniet kontraktuale janë kryer me pronarët juridikë të ngastrës kadastrale kontestuese dhe në të cilat kontrata [parashtruesit e kërkesës] nuk kanë qenë palë kontraktuese”*; dhe se (iv) A.K. të drejtën e pronës në paluajtshmërinë e kontestuar e ka fituar në bazë të kontratës së dhurimit, të 14 korrikut 2012, e lidhur në mes të saj dhe bashkëshortit të saj, tashmë të ndjerit Sh.K.
94. Në fund, Gjykata i referohet edhe arsyetimit të ofruar në Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, e cila e konsideroi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatave të shkallës më të ulët dhe vlerësoi se nuk qëndrojnë pretendimet e revizionit lidhur me (i) nulitetin e kontratave të dhurimit; (ii) cenimit të pjesës së domosdoshme të trashëgimisë; dhe (iii) vërtetimit të pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata Supreme specifikoi se: *“[...] sepse në bazë të dispozitave ligjore, (neni 20 i LMTHPJ [Ligji mbi marrëdhëniet themelore juridike-pronësore], përkatësisht, neni 36 i LPDS [Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore]) rezulton se e drejta e pronësisë fitohet sipas ligjit, në bazë të veprimit juridik (punës juridike) dhe me trashëgimi apo me vendim të organit shtetëror në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me ligj. Në rastin konkret juridiko-civil [parashtruesit e kërkesës] nuk e kanë provuar as bazën juridike e as mënyrën e fitimit (iustus titullus-modus aquirendi) të pronësisë në paluajtshmërisë kontestuese. Ndërkohë që, kontratat e sipërpërmendura (si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë), anulimin e të cilave e kërkojnë [parashtruesit e kërkesës] me padi, nuk janë lidhur në kundërshtim me dispozitat e nenit 103 dhe nenit 111 të LMD-së [Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve], nuk janë në kundërshtim, pra, me parimet dhe rendin juridik kushtetues, me dispozitat imperative etj, të njëjtat nuk janë lidhur me (vi, clam, precario) me mashtrim, kërcenim, lajthim. Në anën tjetër, rezulton, po ashtu, se e drejta e pronësisë, është bartur në të paditurën e parë [A.K.], në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi [...]”*.
95. Në vijim, përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se përmes kontratave për mbajtjen e përjetshme ishte cenuar pjesa e domosdoshme e

trashëgimisë, Gjykata Supreme vlerësoi se: “[...] në rastin konkret juridiko-civil, nuk kemi të bëjmë me cenimin e pjesës së domosdoshme, (portio legitima) për faktin sepse sipas nocionit ligjor të Kontratës mbi mbajtjen e përjetshme rezulton se e njëjta nuk është kontratë për trashëgiminë. Ajo është një kontratë me prestime dhe detyrime të dyanshme, me të cilën ushqimmarrësi disponon gjatë jetës me pasurinë e tij. Me këtë kontratë tjetërsohet pasuria e cila është objekt i saj, prandaj, pasuria e cila është objekt i kontratës nuk bën pjesë në masën trashëgimore të ushqimmarrësit dhe e cila nuk mund të shqyrtohet me rastin e shqyrtimit të trashëgimisë së tij, pasi që gjatë jetës së tij është tjetërsuar nga ai. Nga këtu, trashëgimtarët e domosdoshëm nuk mund ta atakojnë kontratën mbi mbajtjen e përjetshme për shkak të cenimit të pjesës së domosdoshme, ngase, u mor vesh, fjala është për kontratë ngarkuese në të cilën reduktimi në dobi të trashëgimtarëve të domosdoshëm nuk vjen në shprehje, ndërkohë që, gjithnjë në kontekstin e mësipërm dhe në llogari të këtij konkludimi, duhet theksuar edhe njëherë faktin se [parashtruesi i kërkesës në rastin KI205/21] nga i ndjeri [I.K.] qysh ne vitin 1985 kishte marrë dhuratë paluajtshmërinë e sipërpërmendur[...]”.

96. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata po ashtu vë në pah se nga gjykatat kërkohet që të shqyrtojnë dhe japin një përgjigje specifike dhe të qartë në lidhje me (i) pretendimet dhe argumentet thelbësore të palës (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 67; dhe *Donadze kundër Gjeorgjisë*, Aktgjykim i 3 marsit 2006, paragrafi 35); (ii) pretendimet dhe argumentet që janë vendimtare për rezultatin e procedurës (shih, rastet e GJEDNJ-së: *Ruiz Torija kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 30; dhe *Hiro Balani kundër Spanjës*, i cituar më lart, paragrafi 28); dhe (iii) pretendimet në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me KEDNJ dhe Protokollet e saj (shih rastin e Gjykatës, KI40/21, parashtrues *Sadik Gashi*, i cituar më lart, paragrafi 50).
97. Bazuar në arsyetimin e ofruar nga Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj, Gjykata vëren se kjo e fundit ka arritur në këtë përfundim pas shqyrtimit të konstatimeve të dhëna përmes aktgjykimeve të Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit dhe pretendimeve të parashtruesve të kërkesës. Në vijim, përkritazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se është refuzuar kërkesa e tyre për caktim të ekspertizës e cila do të trajtonte kontributin e tyre në ndërtimin e shtëpisë në paluajtshmërinë e kontestuar përmes kredive financiare, e lidhur me banka të ndryshme gjatë periudhës 1978-1989, Gjykata vë në pah se Gjykata Themelore kishte ofruar një konstatim në lidhje me kreditë financiarë, si në emër të parashtruesve ashtu edhe në emër të të ndjerëve I.K. dhe Sh.K. duke theksuar se në këtë gjykatë nuk ishin dorëzuar dëshmi në lidhje me destinimin e këtyre shumave në ndërtimin e shtëpisë në paluajtshmërinë e kontestuar. Për më tepër, bazuar në përmbajtjen e kërkesëpadsisë së parashtruesve të kërkesës, si dhe konstatimet e gjykatave të rregullta që ndërlidhen me të gjitha pikat e kërkesëpadsisë, Gjykata vëren se pretendim thelbësor ishte çështja e anulimit të kontratave për mbajtje të përjetshme dhe atyre të dhurimit, me arsyetimin se përmes këtyre dhuratave ishte cenuar pjesa e domosdoshme e trashëgimisë. Përderisa gjykatat e rregullta, përfshirë dhe ajo Supreme kishin konstatuar se nuk ishte cenuar pjesa e domosdoshme e trashëgimisë, duke arsyetuar se paluajtshmëria e kontestuar kishte qenë në pronësi të të ndjerit I.K., dhe se ky i fundit përmes kontratës së dhurimit, të

vitit 1985 të birit të tij, parashtruesit të kërkesës [Sahit Kabashit] i kishte dhuruar një paluajtshmëri tjetër me shtëpi.

98. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në refuzimin e një ankese, apo siç është rasti konkret, në refuzimin e revizionit, Gjykata Supreme, në parim, thjesht mund të miratojë arsyet për nxjerrjen e vendimit të gjykatave më të ulëta, në këtë rast Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore (shih rastet e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; *Helle kundër Finlandës*, i cituar më lart, paragrafët 59-60).
99. Në këtë kontekst, Gjykata po ashtu rikujton se në rastet kur një gjykatë e shkallës së tretë, si në rastin e parashtruesit të kërkesës Gjykata Supreme, e cila vërteton vendimet e marra nga gjykatat më të ulëta – obligimi i saj për të arsyetuar vendimmarrjen dallon nga rastet kur një gjykatë ndryshon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta. Në rastin konkret, Gjykata Supreme nuk ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Apelit e as atë të Gjykatës Themelore, përmes të cilës kërkesëpadia e parashtruesve kërkesës është refuzuar si e pabazuar (shih rastin e Gjykatës KI194/18, me parashtrues *Kadri Muriqi dhe Zenun Muriqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shkurtit 2020, paragrafi 106).
100. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se, ndonëse Gjykata Supreme mund të mos jetë përgjegjbur në secilën pikë të mundshme të ngritur nga parashtruesit e kërkesës në revizionin e tyre, ajo i ka adresuar argumentet thelbësore që ndërlidhen me zbatimin e së drejtës materiale dhe asaj procedurale (shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së: *Van de Hurk kundër Holandës*, paragrafi 61; *Buzescu kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 63; dhe *Pronina kundër Ukrainës*, i cituar më lart, paragrafi 25, shih rastin e Gjykatës KI194/18, parashtrues *Kadri Muriqi dhe Zenun Muriqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shkurtit 2020, paragrafi 107).
101. Bazuar në si më sipër, Gjykata konstaton që parashtruesit e kërkesës nuk e kanë mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tyre për mosarsyetim të vendimit gjyqësor, gjegjësisht pretendimin specifik se Gjykata Supreme nuk ka adresuar pretendimet e tyre të ngritura në revizion.
102. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në sqarimet si më sipër, dhe në mënyrë specifike duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesit e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ata, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta e të shtjelluara më lart, konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk karakterizohet me mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor. Rrjedhimisht, pretendimi i parashtruesve të kërkesës përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese në “mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes” ashtu siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

II. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenit 17 të DUDNJ-së

103. Gjykata fillimisht vë në pah se parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të së drejtës për mbrojtjen e pronës, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenin 17 të DUDNJ-së. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës nuk kanë specifikuar se si kjo e drejtë është shkelur në rastin e tyre, por vetëm kanë përmendur se pretendojnë që janë bashkëpronar në ½ pjesë ideale të paluajtshmërisë së kontestuar.
104. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata rikujton se neni 46 i Kushtetutës nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës. Një qëndrim i tillë mbështetet edhe në praktikën e GJEDNJ-së (shih *Van der Mussele kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 23 nëntorit 1983, paragrafi 48; dhe *Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë*, Aktgjykimi i 9 tetorit 2003, paragrafi 121).
105. Parashtruesit e kërkesës mund të pretendojnë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, vetëm për atë që vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me “pronën” e tyre. Brenda kuptimit të kësaj dispozite, “pronë” mund të jetë “pasuria ekzistuese”, duke përfshirë edhe pretendimet në bazë të të cilave parashtruesit e kërkesës mund të pretendojnë “pritshmëri legjitime” që do të fitojnë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte pronësore (shih rastet e Gjykatës KI26/18, me parashtrues *Jugokoka*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 6 nëntorit 2018, paragrafi 49; KI156/18, me parashtrues *Verica (Aleksić) Vasić dhe Vojislav Čađenović*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 17 korrikut 2019, paragrafi 52; dhe rastin e Gjykatës KI41/19, me parashtrues *Ramadan Koçinaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 janarit 2020, paragrafi 60).
106. Gjykata rikujton se kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës, që në mënyrë specifike i referohej kërkesës së tyre për vërtetim të pronësisë në ½ pjesën ideale të paluajtshmërisë së kontestuar ishte refuzuar nga Gjykata Themelore, dhe më pas ky konstatim ishte vërtetuar edhe përmes aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme.
107. Gjykata po ashtu vë në pah se parashtruesi i kërkesës pretendimin e tij për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenit 17 të DUDNJ-së po ashtu e ndërlidhin me pretendimin e tij për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si rezultat i mosarsyetimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës Supreme. Në këtë kuptim, Gjykata rikujton se përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së ka konstatuar se ky pretendim është qartazi të pabazuara në baza kushtetuese në “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes” ashtu siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.
108. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se edhe pretendimi i parashtruesve të kërkesës për shkelje të së drejtës së tyre në pronë, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenit 17

të DUDNJ-së është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese në “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes” ashtu siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Përfundim

109. Prandaj dhe përfundimisht, Gjkata konstaton se kërkesa e parashtresve të kërkesës është e papranueshme, sepse pretendimet e tyre:

- I. Përkitazi me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së që ndërlidhen me mosarsyetim të vendimit gjyqësor është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese në “mungesë evidente ose të dukshme të shkeljes” ashtu siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës; dhe
- II. Përkitazi me nenin 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenit 17 të DUDNJ-së është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese në “mungesë evidente ose të dukshme të shkeljes” ashtu siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjkata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, me nenet 20, 47 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (b) dhe (d) dhe (2) të Rregullores së punës, më 9 mars 2022, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani